



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
**MINISTRIA E BUJQËSISË,  
ZHVILLIMIT RURAL DHE  
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr . .....Prot.

Tiranë, më /01 /2014

Lenda : Monitorimi i realizimit vjetor te buxhetit te vitit 2013.

**Drejtuar:       MINISTRISË SE FINANCAVE                               TIRANE**  
**DREJTORISË PERGJITHSHME TE BUXHETIT**

**Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave** , për vitin 2013 i janë akorduar fondet buxhetore, sipas shtatë programeve të miratuara për sistemin e bujqësisë dhe të ushqimit, e konkretisht:


- ❖ Planifikim, Menaxhim dhe Administrim
- ❖ Siguria ushqimore, Mbrojtja e Konsumatorit
- ❖ Infrastruktura e Kullimit dhe Ujitjes
- ❖ Zhvillimi Rural duke Mbështetur Prodhimin Bujqësor, Blegtoral, Agroindustrial dhe Marketingun.
- ❖ Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor
- ❖ Menaxhimi i Qëndrueshem i Tokës Bujqësore
- ❖ Administrimi i Ujrave

Buxheti vjetor 2013 , i planifikuar për këto 7 programe, është realizuar si vjetor në masën 100,8 përqind ndaj planit vjetor perfundimtar dhe paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Buxheti vjetor është 5.710 milion dhe është realizuar 5.755 milion lekë të detajuar sipas programeve , paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Nr	Emri i programit	Buxheti 2013(mln leke)	Struktura Ne %	Fakti vjetor 2013		
				Ne mln leke %	Ne % ndaj buxh	Struk ne
1	Planif menaxh, administrimi	255	4,5	223	87	4
2	Siguria ushq. mbro. konsumat.	1754	31	1909	109	33
3	Infrastrukt e ujitjes, kullimit	1562	27	1383	88,5	24
4	Zhvillimi rural	1894	33	2029	107	35
5	Keshillimi dhe inf. bujqesor	215	4	189	88	2,7
6	Menaxh i tokes bujq.	19	0.3	17	89	0,3
7	Administrimi i ujrave	11	0,2	5	45	1
	<b>Totali</b>	<b>5710</b>	<b>100</b>	<b>5755</b>	<b>100,8</b>	<b>100</b>


Rreth 109 përqind e totalit të shpenzimeve faktike të kryera gjatë vitit 2013 e zenë shpenzimet për programin “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit” me 109% dhe “Zhvillimi rural” me 107 % ndaj totalit të faktit.



Struktura e shpenzimeve të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, për çdo program, sipas PBA-së, buxhetit të 2013 dhe realizimit faktik për vitin 2013, jepet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm.

Nr	Emri i programit	Struktura e Shpenzimeve sipas PBA-se 2013	Në %	
			Struktura e Shpenzimeve sipas Buxhetit 2013	Struktura e Shpenzimeve faktike vitin 2013
1	Planif menaxh, administrimi	3.7	4,5	4
2	Siguria ushq, mbr. konsumat.	26.7	31	33
3	Infrastrukt e ujitjes, kullimit	38.1	27	24
4	Mbeshtetja prodh bujq-bleg	27.3	33	35
5	Keshillimi dhe inf. bujqesor	4.1	4	2,7

6	Menaxh i tokes bujq	<b>0.2</b>	0.3	0,3
7	Administrimi i ujrave		0,2	1
	<b>TOTALI</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>



### Monitorimi i shpenzimeve sipas programeve

#### 1. Programi “Planifikim, menaxhim, administrim”.

Realizimi i shpenzimeve të vitit 2013 për këtë program, që përfaqëson **rreth 4 përqind të** realizimit të kësaj ministrie, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor rezultojnë si më poshtë:

- Shpenzimet korente 87 përqind
- Shpenzimet kapitale 0 përqind
- **Gjithsej 87 përqind**

Për vitin 2013 parashikuar 6 produkte, në këtë program, të cilat rezultojnë të plotësuar si më poshtë.

Produkti	Buxheti 2013 ne mln leke	Realizimi faktik i 2013		
		Ne milione leke	Ne %	Statusi i realizimit
Funks i kapac. menaxh per impl. e pol. bujq.	167	152	91	Plotesisht
Ngritja profesionale e stafit	52	41	79	Pjesrisht
Menaxhimi i pergji. i institucionit	6	6	100	Plotesisht
Detyrime per antarsimi ne org. nderk.	30	24	80	Pjesrisht
<b>TOTALI</b>	<b>255</b>	<b>223</b>	<b>87</b>	

Shpenzimet e këtij programi për paga ndaj planit vjetor janë realizuar 91 %, sigurimet shoqërore 91 %, shpenzime operative 80 %.Niveli I realizimit prej 91% te shpenzimeve te personelit shpjegohet me faktin qe gjate vitit kane qene ne menyre permanente 7 vende vakante.

## **2-Programi “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit”.**

Politika në fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit synon përmirësimin e kuadrit ligjor duke e përshtatur atë me legjislacionin e BE-së, hartimin dhe zbatimin e programeve kombëtare të kontrollit të semundjeve në kafshë e parazitëve në bimë, programeve të monitorimit të sëmundjeve, mbetjeve në kafshë dhe ne produktet ushqimore me origjinë shtazore, monitorimit të ujrave e molusqeve bivalente, identifikimin e kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale, forcimin e karantinës veterinarë e fitosanitare, përdorimin e praktikave të mira në mbrojtjen e shëndetit të bimëve, fuqizimin e rrjetit laboratorik, fuqizimin e inspektimeve mbi sigurinë ushqimore, vendosjen e sistemit të vetëkontrollit dhe informimin në kohë të konsumatorit.

Për vitin 2013 u punua për realizimin e aktiviteteve mbi masat profilaktike veterinarë e fitosanitare, monitorimin e mbetjeve në kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë prej tyre, monitorimin e ujrave e molusqeve bivalente, identifikimin e kafshëve dhe hedhjen e të dhënave në database.

Produktet e përfuara për vitin 2013, parashikuar në PBA për vitin 2013, të pasqyruara në aneksin bashkëngjitur, janë realizuar si më poshtë, Mbi kontrollin e situatës epizootike është realizuar sipas programit vaksinimi kundër sëmundjes së plasjes (produkti I dhe J) dhe vaksinimi kundër sëmundjes së Murtajës Klasike në Derra (produkti F).

Ka përfunduar në bashkëpunim me projektin PAZA “ Përmirësimi i shëndetit të njerëzve duke luftuar sëmundjet zoonotike”. vaksinimi kundër sëmundjes së brucelozës në të imta (produkti G) që zë peshën më të madhe në masat profilaktike për vitin 2013. Janë vaksinuar mbi 2.470.581 mijë krerë të imta nga 2.526.200 krerë të planifikuara (vaksinim masiv).

- Realizimi i programeve të monitorimit, është një proces i vazhdueshëm dhe analitik vjetor. Për vitin 2013 programi kombëtar i monitorimit ka filluar në muajin Prill dhe përfundon në Prill të vitit 2013 dhe pse për vitin kalendarik 2013 ka përfunduar analizimi i mostrave të parashikuara (produkti C, D).
- Monitorimi i sëmundjeve ka filluar dhe është në proces (produkti E).
- Vazhdon procesi i matrikullimit të remontit, ku ka përfunduar identifikimi i remontit në të imta dhe në gjedhë. (produkti B).
- Pë vitin 2013 në fushën e mbrojtjes së bimëve kanë përfunduar masat e parashikuara të luftimit të miut të arave, karkalecit, monotorimi i zonës së lirë të patates, etj.
- Janë realizuar shpenzimet operative, fondi i pagave dhe sigurimet shoqërore sipas parashikimit në buxhetin 2013 për DRB-së, ISUV, dhe AKU ( produkti Q,R, S).
- Janë realizuar shpenzimet të investimeve në zërat TVSH dhe kosto lokale, në zbatimin e projekteve në fushën e sigurisë ushqimore dhe veterinarisë, implementimi i të cilëve është në vazhdimësi (produkti T,U).

Në totalin e tyre janë realizuar të gjitha aktivitetet në fushën e sigurisë ushqimore gjë që pasqyrohet me realizimin e buxhetit të alokuar në masën 100 %

Produkti	Buxheti 2013 ne mln leke	Realizimi i vitit I 2013		
		Ne milione leke	Ne %	Statusi i realizimit
Legjislacion i perafruar me aktet normative te BE-se	3,757.0	3,757.0	100	Plotesisht
Kafshe te identifikuar ne gjithe vendin - Gjedhe remonti - Te imta	16,513.5	16,020.0	94	Plotesisht
Analiza te kryera sipas programit per mbetjet ne kafshe e produkte prej tyre	6,100.0	6,120.0	100	Plotesisht
Analiza te kryera sipas programit per mbetjet ne ujra e molusqe bivalve.	3,000.0	2,600.0	87	pjeserisht
Semundje ne kafshe , te monitoruara - Kafshe te ujit	-	-	-	aspak
-Kafshe te Tokes	1,000.0	1,000.0	100	Plotesisht
Derra te vaksinuar k/murtajes klasike.	3,850.0	3,690.0	96	Plotesisht
Te imta te vaksinuara k/ brucelozes (Rev1).	123,539.0	123,539.0	100	Plotesisht
Vaksinim kunder terbimit	250.0	250.0	100	Plotesisht
Kafshe gjedhe te gjurmuara per tuberkuloz.	-	450.9		Realizuar si produkt
Kafshe gjedhe vaksinuar k/plasjes.	4,776.0	3,896.1	82	pjeserisht
Kafshe te imta, etj vaksinuar k/plasjes.	20,020.0	18,861.1	94	pjeserisht
Kafshe gjedhe te eleminuara si te infektuara nga bruceloza, plasja, tuberkulozi.	12,438.5	12,438.5	100	Plotesisht
-Te imta te eleminuara	6,200.0	6,200.0	100	Plotesisht

Rrenje ullinj dhe peme frutore te trajtuara k/mizes dhe f. bardhe te manit.	7,550.0	6,782.8	90	pjeserisht
Peme frutore te asgjesuara si te infektuara.	800.0	600.0	75	pjeserisht
Siperfaqe e trajtuar k/ miut te arave dhe karkalecit.	8,200.0	5,800.0	71	pjeserisht
Zone e lire per prodhimin e patates e monitoruar.	1,000.0	1,000.0	100	Plotesisht
Prodhim certifikata fito-sanitare	450.0	450.0	100	Plotesisht
Kafshe gjedhe te gjurmuar per bruceloze.	-	567.3		Realizuar si produkt
Kafshe gjedhe te vaksinuar k/brucelozes	-	-	0	aspak
AKU e plotesuar me kapacitetet per funksionimin e plote - Paga	367,325.2	363,929.9	99	Plotesisht
- operative	50,923.0	42,054.0	83	pjeserisht
- investime	-	-	0	aspak
- trajnim, sensibilizim	-	-	0	aspak
Instituti I sigurise Ushqimore i fuqizuar dhe me kapacitete te plotesuara.- Paga	86,797.6	86,797.6	100	Plotesisht
- operative	21,400.0	14,400.0	67	pjeserisht
- investime	-	-	0	aspak
DRBU-te ne qarqe te plotesuara me kapacitetet e nevojshme funksionale.- Paga	418,592.9	405,570.2	97	Plotesisht
- operative	72,066.0	68,002.0	94	pjeserisht
- investime	-	-	0	aspak
Projektet ne fushen e sigurise ushqimore te				

mbeshtetura nga MBUMK.				
- IPA-2008-TVSH	7,000.0	4,647.6	66	pjeserisht
- IPA-2008-Kosto lokale	50,480.0	120,506.0	234	Tejkaluar
Transferta ne buxhetet familjare	2,284.3	2,283.7	100	Plotesisht
Fuqizimi i shendetit te njerezve kunder zoonozave, 5 semundje zoonotike.(IPA 2008)				
IPA-2010 TVSH	132,200.0	57,170.0	43	pjeserisht
IPA-2010 Kosto lokale	325,800.0	525,597.1	161	Tejkaluar
IPA-2012	-	3,812.0		Realizuar si produkt
<b>TOTALI</b>	<b>1.754.313</b>	<b>1.908.793</b>	<b>109</b>	

### 3.Programi “Infrastruktura e kullimit dhe ujitjes”

Ky eshte nje nga programet kryesore te Ministrise se Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit qe ofron sherbimin e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga permytja, si nje nga faktoret e rendesishem me ndikim te drejtperdrejte ne rritjen e prodhimit bujqesor.

Realizimi i shpenzimeve vitit 2013, per kete program, qe perfaqeson rreth 24 perqind te totalit te buxhetit fakt te kesaj ministrie, sipas zerave kryesor, krahasuar me planin vjetor, rezulton si me poshte:

- Shpenzimet Korente 98 perqind
- Shpenzimet kapitale 74 perqind
- **Gjithsej 88 perqind**

❖ Shpenzimet per pagat dhe sigurime shoqerore jane realizuar 99 % te fondit vjetor te planifikuar ,shpenzimet operative 98 % ndersa investimet si realizim financiar paraqitet ne 74 % .

Produkti	Buxheti 2013 ne mln leke	Realizimi i vitit I 2013		
		Ne milione leke	Ne %	Statusi i realizimit
Infrastruktura e kullimit dhe ujitjes				
Rrjeti i kanaleve kullues i mirembajtur (pastruar nga depozitimet e dherave dhe bimesia)	309	305	99	Plotesisht
Rrjeti i kanaleve ujitjes i mirembajtur (pastruar nga depozitimet e dherave dhe bimesia)	191	189	99	Plotesish
Argjinatura te mirembajtura ne menyre rutine	10	9	95	Plotesish

Sherbimi i kullimit me ngritje mekanike me hidrovore	425	418	98	Plotesish
Inspektime teknike te sigurise se digave	4	4	100	Plotesish
Inspektime teknike te infrastruktures se ujitjes, kulimit dhe mbrojtjes nga permbytja ne zonen e sherbimit te ujitjes 360 000 ha dhe zonen e sherbimit te kullimit 280 000 ha perfshi dhe 28 hidrovoret	3	3	100	Plotesish
Rrjete te permiresuara te kanaleve te kullimit	17	16	94	Plotesish
Rrjete te kanaleve ujitise te rehabilituara dhe permiresuara	147	138	94	Plotesish
Diga te rezervuareve te rehabilituara pjeserisht	42	35	83	Plotesish
Diga te rezervuareve te rehabilituara plotesisht	238	108	45	Pjeserisht
Argjinatura te reja te ndertuara	81	67	83	Plotesish
Argjinatura te rikonstruktuar	69	66	96	Plotesisht
Argjinatura te rehabilituara	25	24	96	plotesisht
Hidrovore te rikonstruktuar dhe riperstatur	1	1	100	plotesisht
<b>TOTALI</b>	<b>1562</b>	<b>1383</b>	<b>88</b>	

Nga shqyrtimi i ecurise se shpenzimeve dhe investimeve te aktiviteteve te produkteve te Programi 04240 "Menaxhimi i Infrastruktures se Kullimit dhe Ujitjes", per 12 mujorin e vitit 2013 rezulton se:

*Finacimi i brendshem:*

*Me investimet e brendshme me vlere limit prej 399.2 milion leke, jane financuar:*

- Rehabilitimi i 44 objekteve te ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga permbytja, nga te cilat 33 objekte i perkasin bordeve te kullimit dhe 11 objekte i perkasin Fondit te Zhvillimit te Rajoneve (qe i perkasin komunave/bashkive).
- Likujdimi i detyrimeve te prapambetura te vitit 2012 per 3 objekte,
- TVSH-ja per Projektin e Burimeve Ujore dhe Ujitjes.

*Me shpenzimet operative prej rreth 571 milion leke (490 buxheti fillestar) jane financuar:*

- Mirembajtja (kryesisht pastrim te kanaleve kullues nga vete bordet e kullimit me mjetet e tyre) ne rreth 75 objekteve te kullimit (kanale kullues) me vlere rreth 110 milion leke. Punimet ne keto objekte kane perfunduar dhe jane kryer kolaudimi dhe likujdimi financiar.
- Mirembajtja (kryesisht pastrim i kanaleve ujitese nga vete bordet e kullimit me mjetet e tyre si dhe mirembajtje rezervuar) e rreth 55 objekteve te ujitjes me vlere rreth 89 milion leke. Punimet ne keto objekte kane perfunduar dhe jane kryer kolaudimi dhe likujdimi financiar.



- Mirembajtja e 11 objekteve te mbrojtjes nga permbytja (riparim argjinature) me vlere rreth 15 milion leke. Rezulton se kane perfunduar punimet dhe likujdimi financiar per 11 objekte dhe jane ne proces kolaudimi.
- Pagesa e energjise elektrike per 29 hidrovor per vitin 2013 ishte planifikuar 179 milion leke. Aktualisht rezulton se jane kryer pagesat per energjine elektrike jo vetem per konsumin e vitit 2013, por me shtesen prej rreth 85 milion leke eshte mundesuar edhe pagesa e detyrimeve te prapambetura (principali) ndaj CEZ-it. Ne keto kushte viti 2014 ka filluar pa detyrime (principal) nda CEZ, por theksojme se ndaj CEZ-it egziston detyrimi i kamat vonesave (qe shkojne rreth 120 milion leke)

Theksojme se nderhyrjet e realizuara ne vitin 2013 mundesuan nje sezon ujites pa probleme ne nje siperfaqe rreth 200 000 ha, ndersa kullimi ka pasur nje shtrirje ne rreth 200 000 ha.

Pamvaresisht permbytjeve ne zonen e Zadrimes ne Lezhe nga dalja e lumit Gjader ne mujin Janar, nderhyrjet e realizuara ne hidrovorin e Tales me instalimin e 2 elektropompave te medha (5.5 m<sup>3</sup>/sekond), ben te mundur shmangien e permbytjeve te rreth 4700 ha te zones se Tales, ne Lezhe (referuar situates me rreshje te shumta te janrit 2014)

### **Financimi i huaj**

Ne lidhje me financimin e huaj, megjithese jane kryer procedurat e prokurimit per disa objekte (rehabilitim i disa digave te rezervuareve Thane ne Lushnje dhe Kurjane ne Fier), akoma nuk kane filluar punimet e zbatimit.

Ne lidhje sa me siper vetem produkti “K”, Diga te rezervuarve te rehabilituara plotesisht “ nuk eshte realizuar plotesisht, kjo pasi ky produkt lidhet kryesisht me financimin e huaj.

## **4. Programi “Zhvillimi rural duke mbeshtetur prodhimin bujqesor e blegtoral, agroindustrine dhe marketingun”.**

Në programin buxhetor të rishikuar të vitit 2013, programit “Zhvillimi Rural në mbështetje të bujqësisë blegtorisë, agroindustrisë dhe marketingut” ju alokuan gjithsej **1 893 744 mijë lekë** dhe përkatësisht:

- Shpenzime korrente	1,292,744 mijë lekë
- Shpenzime kapitale	601,000 mijë lekë

Realizimi i këtyre fondeve për vitin 2013 në zërin e shpenzimeve është më i madh se ai i planifikuar për arsye të disbursimit të fondeve IPA nga donatorët, si dhe realizimi nga SDRMA mbi fondet e planifikuara.

Realizimi sipas produkteve :

1. Për **“Ruajtjen e resurseve gjenetike në fermë”**. Në këtë zë shpenzimesh përfshihen shpenzimet për Buajt, Bagëtitë e Imta, si dhe shpenzimet për përmirësimin racor. Me VKM nr.1634 datë 17.12.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të mënyrës së mbështetjes financiare për ruajtjen e rezervës gjenetike të racës autoktone të buajve”, si dhe Urdhërit të Ministrit nr. 84 datë 02.03.2008, si dhe mbështetur në VKM nr.1708 datë 29.12.2008 “Për zbatimin e programeve për ruajtjen in-situ të racave autoktone të bagëtitë të imta” shoqëruar me rregulloren përkatëse nr.4 datë 18.08.2009; u alokuan me buxhet të rishikuar 4.4 milion lekë për buajt dhe bagëtitë e imta. Nga ana e Ministrisë dhe institucioneve përkatëse u punua me plotësimin e kartelave dhe çertifikatave veterinarë të tyre. Është bërë disbursimi i fondeve sipas VKM përkatëse. Ka patur rënie të numrit të krerëve për efekt të moshës së vjetër e për këtë arsye fondi është realizuar në masë të ulët.

Është parashikuar dhe një fond prej 1.7 milion lekë për përmirësimin racor në DRB-të e qarqeve, për të cilat janë përgatitur dhe rregulloret udhëzimet përkatëse për ngritjen e një databaze.

Fondi është realizuar në masën 67% .

2. **“Marketingu”**. Promovim i produkteve shqiptare të sektorit bujqësor, blegtoral dhe agropërpunimit, përmes pjesëmarrjes në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare. Në mbështetje të objektivave të ministrisë për përmirësimin e infrastrukturës së marketingut dhe nxitjen e biznesit vendas për vitin 2013 u planifikuan të mbështeten 5 panairë ndërkombëtare dhe 3 panairë lokale. Nga të cilët, sipas urdhërit të ministrit, për këtë qëllim, gjatë vitit 2013, u organizua pjesëmarrja në panirin “Green Eëek 2013”, Berlin Gjermani; panairi “Made in Albania 2013” në Amerikë, “Pavioni i Agrobiznesit” në panairin ndërkombëtar të tregtisë në Tiranë, si dhe panairi rajonal “Agroturizmi 2013”, në Vlorë. Fondet u realizuan në masën 83%.

Organizimi i këtyre aktiviteteve si brenda ashtu dhe jashtë vendit pati një impakt pozitiv, si për bizneset ashtu dhe për konsumatorin shqiptar.

Theksojmë se panairi “Teknologjisë dhe Inovacionit” planifikuar për t’u realizuar në muajin maj 2013, në bashkëpunim me Albkofindustrinë, nuk është kryer për arsye objektive (mungesë biznesesh). Gjithashtu mbetën pa realizuar dhe 2 nga panairët rajonale të planifikuara.

3. **“Përmirësimi i infrastrukturës ruale”** nga Projekti MMP dhe SDRMA; konsiston në ndërtimin e rrugëve rurale, lerava të bagëtitë, skemave ujitëse, si dhe dhënien e grondeve konkurruese përmes një procedure seleksionimi. Kjo u realizua përmes disbursimit të fondeve të projektit si dhe mbështetjes me Kosto lokale e TVSH nga fondet buxhetore. Gjatë vitit 2013 janë kryer pagesat e prapambetura nga viti i kaluar për objektet në vazhdim si dhe kontratat e lidhura, si dhe procedurat e prokurimit për një sërë kontratash të reja.

Fondet janë realizuar në një masë më të lartë se fondi i planifikuar për arsye të dibursimeve të fondit nga donatori, për mbylljen e kontratave dhe punimeve. Gjithashtu dhe fondi i planifikuar për TVSH dhe Kosto Lokale është realizuar pothuajse 100%, kjo paralelisht me fondin e harxhuar për financimin e huaj.

Me një realizim jo të kënaqshëm është Grandi frances.

4. **“Promovimi i teknologjive të reja për mbjelljen, mbledhjen dhe ruajtjen e duhanit”**, përmes rritjes së sipërfaqes së kultivarëve të çertifikuar, rritjes së eksportit dhe cilësisë; produkt ky i cili realizohet nga Agjensia Kombëtare e Duhan Cigareve. Gjatë kësaj periudhe janë mbjellë rreth 2.5 ha duhan si dhe 15 ha grurë, duke përdorur kultivarëve të mirë të farës së duhanit për monitorimin tërësor të prodhimit, grumbullim-përpunimit dhe eksportit, përmes promovimit të teknologjive të reja. Janë kryer analiza fiziko-kimike për rreth 90 mostra si dhe analiza puroshe dhe duhane për 45 mostra. Ka vazhduar puna gjithashtu dhe në drejtim të përditësimit të të dhënave të rregjistrit Kombëtar të Prodhuesve të duhanit. Janë blerë për Stacionin e duhanit Cërrik, reagentë e materiale, herbicide e plehra kimike, si dhe janë kryer pagesat për degustuesit e mostrave të cigareve.

Fondi i realizuar arrin në 90% për vitin 2013.

5. **“Rritja e sipërfaqes së mbjellë përmes skemave mbështetëse për zhvillimin e bujqësisë”**. Për vitin 2013 (buxhet i rishikuar) për skemat mbështetëse është planifikuar fondi prej 1 077 milion lekë duke përfshirë këtu dhe fondin e planifikuar si bashkëfinancim në kuadër të projektit IPA 2011. Është parashikuar të mbillen rreth 2000 ha me vreshta dhe pemë frutore si dhe 2000 ha me ullinj. Është kryer informimi mediatik i publikut. Fondet janë drejtuar në mbështetje të: skemave të fermerëve, shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, si dhe pagesën e normës së interesit në sektorin e agropërpunimit dhe mekanikës bujqësore.

Gjatë vitit 2013, janë financuar për mbjelljet e reja 3 768 projekte për fermerët, 4 projekte për Shoqatat e Bashkëpunimit Bujqësor, si dhe 57 projekte për normë interesi. Gjithashtu janë financuar dhe 1 764 projekte të fituara nga viti 2012. Realizimi për vitin 2013, arriti në 79%.

6. **“Vrojtime statistikore”**: Për këtë vit janë parashikuar shpenzimet për kryerjen e vrojtimeve statistikore, si dhe mirëmbajtja e sistemit të informacionit SITA. Shpenzimet gjatë vitit u kryen vetëm për printimet e vrojtimeve, ndërkohë që shpenzimet për mirëmbajtjen e sistemit u mbuluan nga shpenzimet e parashikuara në aparatën e ministrisë.

7. **“Rritje në masën 25% e çertifikimit të farërave të grurit, misrit, patates dhe perimeve, si dhe rritje prej 10% të analizave dhe testeve”**; realizohet përmes Entit Shtetëror të Farnave dhe Fidanëve. Realizimi i fondit për vitin 2013 është rreth **95%**. Gjatë vitit janë kryer çertifikimi në: 896 600 rrënjë fidanë; 3 000 000 rrënjë sherebelë; 12 432kv grurë; 77kv misër; etj; si dhe janë kryer rreth 442 analiza laboratorike. Kemi pasur një rritje të numrit të çertifikimeve dhe analizave laboratorike si rezultat i rritjes së sipërfaqeve të mbjella me kultura bujqësore për të cilat jepet subvencion fermerësh. Është ndjekur zbatimi i standarteve shqiptare për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor; janë respektuar kushtet e domosdoshme agroteknike në ngastrat e prodhimit, të riprodhimit dhe shumëzimit të farërave dhe fidanëve; për çdo rast dhe në kohën e duhur është kryer ndërtimi i “Buletimit të Çertifikimit” të materilit mbjellës dhe shumëzues bimor të prodhuar në vend duke e shpërndarë në çdo rreth e më tej; është paisur me çertifikatë garancie dhe etiketa zyrtare të gjithë materiali mbjellës bimor i prodhuar në vend, janë bërë ndryshimet e nevojshme në Katalogun Kombëtar Zyrtar Shqiptar; është bërë shpërndarja e listët kombëtare të varieteteve; etj.

Gjithashtu është kryer testimi në: 51 hibride misër; 4 varietete patatesh; 16 varietete grurë; 110 varietete perimesh, etj.

8. **“Mbështetje strukturore për zbatimin e të gjitha skemave në bujqësi”**; përfshihen fondet e planifikuara për Agjensinë e Zhvillimit Bujqësor Rural e cila zbaton skemat mbështetëse në

bujqësi. Realizimi i fondeve për vitin 2013 është në masën 96%. Shpenzimet për detyrime e kompensime legale janë realizuar në një masë shumë të ulët nga ajo e planifikuar për arsye të vazhdimit të seancave gjyqësore, etj.

9. **“Rregjistrimi i sipërfaqes me vreshta për 2000 njësi vreshti”** (kadastra e vreshtarisë dhe verës). Me përfundimin e projektit të BE-së për krijimin e kadastrës së vreshtarisë dhe verës, duhet të përfundojë dhe të vazhdojë puna për rregjistrimin e gjithë sipërfaqes së mbetur dhe mirëmbajtjen e sistemit të ngritur. Për këtë arsye u parashikua një fond prej 5 milion lekë për QTTB Fushë-Krujë. U parashikua të mbulohej gjatë vitit, 2000 njësi vreshti, por nuk u krye asnjë pagesë nga ky fond pasi, sipas përfaqësuesve të QTTB Fushë Krujë, nuk ka pasur një miratim të planit të punës për këtë qëllim nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Bujqësore në Ministri.

10. **“Shpenzime për hartimin dhe mirëmbajtjen e kadastrës së ullirit”**, nga QTTB Fushë-Krujë. Ka filluar puna për grumbullimin e informacionit të nevojshëm për krijimin e rregjistrimit, si dhe janë kryer disa rregjistrime, në fillim të vitit, por për të njëjtat arsye (si për kadastrën e vreshtarisë) nuk ka vazhduar më tej puna.

11. **“Fuqizimi i kapaciteteve të MBUMK-së”**, përmes implementimit të projekteve të huaja që veprojnë në këtë fushë. Për vitin 2013 janë planifikuar të veprojnë në këtë program: Projekti IPA 2011; IPA 2012, si dhe IPA Adriatica.

Pothuajse për të gjitha projektet janë kryer disbursime fondesh:

- **Projekti IPA Adriatica:** ka kryer shpenzime kryesisht për: pjesëmarrje në trainime, udhëtime studimore, etj, në fushën e blegtorisë;

- **IPA 2012”Fondi Garancise Rurale:** Nga informacioni që kemi siguruar nga Delegacioni Evropian në Tiranë, patëm një disbursim për këtë projekt gjatë 3 mujorit të fundit të vitit;

12. **Shpenzime për serën e fidanëve të ullirit.** Fond ky i cili menaxhohet nga QTTB Vlorë dhe përfshihen shpenzimet për serën e fidanëve, të ngritur në kuadër të nismës së Qeverisë për mbjelljen e 20 milion rrënjë ullinj. Realizimi i fondeve kryhet mbi bazën e situacioneve mujore të shpenzimeve. Për vitin 2013, ky fond u realizua në masën 80% ndaj fondit të planifikuar për këtë qëllim, për: bazë materiale (kalema, qese plasmasi, etj), energji dhe ujë, karburant, mirëmbajtje e sistemit të serrës dhe sitemit të ujitjes, etj.

Produkti	Buxheti 2013 ne mln leke	Realizimi v. i 9mI 2013		
		Ne milione leke	Ne %	Statusi i realizimit
Ruajtja e resurseve gjenetike ne ferme (buajt, te imta, krimbi mendafshit)sipas legjislacionit	6.1	4	66%	Pjesrisht
Promovimi I produkteve shqiptare te sekt bujq,blegtoral dhe agrop.ne panaire komb e nderk	12.5	10	80%	Pjesrisht
Permiresimi I infrastr.rurale permes ndertimit te 12 rrugeve rurale; 4 lera bagetish; 10 skema	380	430	113%	Plotesish

ujitese; 120 grande konkruuese (MADA)				
Promovimi i teknologjive te reja per mbjelljen,mbledhjen dhe ruajtjen e duhanit (AKDC)	23	20	87%	Pjesrisht
Rritja e siperf se mbjelle permes skemavembeshtetese per zhvillimin e bujqesise	1078	847	78%	Pjesrisht
Botime, buletini bujqesor	2,5	0,05	2%	Pjesrisht
Rritje ne masen 25% e çertifikimit te farerave te grurit, misrit, patates dhe perimeve, si dhe rritje prej 10% te analizave dhe testimeve (Enti farerave)	25	23	92%	Pjesrisht
Mbeshtetje strukurore per zbatimin e te gjitha skemave (AZHBR)	130	126	97%	Pjesrisht
Rregjistrimi i siperfaqes me vreshta per 2000 njesi vreshti (kadastra vresht.e veres)	5	0	0%	Aspak
Kadastra e Ullirit	3	0,001	0.03%	Pjesrisht
Fuqizimi I kapaciteteve te MBUMK permes implementimit te projekteve te huaja(IPA 2011, IPA Adriatica,Protokolli Italian)	221	562	254%	Plotesish
Shpenzime per seren e fidaneve te ullirit	7,5	6	80%	Pjesrisht
<b>TOTALI</b>	<b>1.894</b>	<b>2.029</b>	<b>107%</b>	

## 5. Programi “ Këshillimi dhe informacioni bujqësor ”

Realizimi i shpenzimeve të vitit 2013, për këtë program, që përfaqëson rreth 4 perqind të totalit të buxhetit fakt të kesaj ministrie, sipas zerave kryesor, krahasuar me planin vjetor, rezulton si me poshte:

- Shpenzimet Korente 88 perqind
- Shpenzimet kapitale 0 perqind
- **Gjithsej 88 perqind**

Ne kete program ne kuader te PBA-se kane qene parashikuar 3 produkte, ecuria e te cilave jepet nga tabela bashkengjitur.

Produkti	Buxheti 2013 ne mln leke	Realizimi i vitit 2013		
		Ne milione leke	Ne %	Statusi i realizimit
Teknologji dhe paketa teknologjike(elemente te permirsuar) dhe studime te ofruara	125	125	100	Plotesisht
Ofrim sherbimesh ekstensionit	54	40	74	Plotesisht
Te ardhura te realizuara nga QTTB	36	24	69	Pjeserisht
<b>TOTALI</b>	<b>215</b>	<b>189</b>	<b>88</b>	

Në programin “Këshillimi & Informacioni Bujqësor” përfshihet financimi i Qendrave të Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shërbimit Këshillimor dhe Informacionit Bujqësor, aktivitetet e të cilave ndiqen nga sektorët përkatës.

***Qëndrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB).***

Qëndrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) gjatë vitit 2013 e kanë përqëndruar aktivitetin e tyre në realizimin e detyrave dhe programit të punës për këtë vit. Për vitin 2013, produktet e këtij programi janë realizuar si vijon:

***Produkti A: Teknologji, paketa teknologjike (elemente të përmirësuar) dhe studime të ofruara.*** Shpenzimet e planifikuara për këtë produkt, për vitin 2013, janë realizuar në masën 100 % krahasuar me planin vjetor të shpenzimeve. Për vitin 2013 ishin planifikuar dhe janë realizuar 16 teknologji/paketa teknologjike (elemente te permirsuar). Aktivitetet që i shërbejnë ***Produktit A*** janë studime, teknika dhe teknologji në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, testime, rigjenerime të koleksioneve gjenetike që përdoren për përmirësimin e hallkave të larta si dhe prodhimi i hallkave të larta të farave dhe fidanëve.

***Produkti B: Ofrim shërbime ekstensionit:*** Shpenzimet për këtë produkt për vitin 2013 janë realizuar në masën 74% Ky produkt realizohet nëpërmjet aktiviteve si: 25 kërkime në nivel ferme të realizuara nga QTTB-të në bashkëpunim me strukturat e Shërbimit Këshillimor në qarqe , përgatitjen dhe shpërndarjen e materialeve divulgative për fermerët dhe trajnimet me specialistë dhe fermerë.

***Produkti C: Të ardhura nga QTTB-të të realizuara.***

Bazuar në Plan bizneset e QTTB-ve për vitin 2013, është punuar për realizimin e të ardhurave, të cilat vijnë kryesisht nga prodhimi i farërave dhe fidanëve si inpute të gjeneracioneve të larta, nga realizimi i analizave laboratorike të ushqimit, tokës dhe hartografia, si dhe nga shpërndarja e materialit biologjik për përmirësimin racor të gjedhit në vend etj.

Në përfundim të vitit 2012, QTTB – të kanë realizuar dhe shpenzuar **24 269** mijë lekë të ardhura nga **36 000** mijë lekë që është limiti i përdorimit të këtyre të ardhurave, pra **69 %**.

Realizimi i të ardhurave ka ardhur prej shitjes së fidanëve të perimeve nga QTTB Lushnje; shitjes së materialit biologjik dhe analizave laboratorike e hartografi nga QTTB Fushë Krujë si dhe shitjes së prodhimeve bujqesore dhe qumeshtit nga QTTB Korçë.

Të ardhurat e parashikuara nuk janë realizuar në masën 100% për shkak se: fidanët e ullirit të prodhuar në QTTB Vlorë nuk janë shitur, fara misrit hibrid prodhuar nga QTTB shkodër shitet në pranverë.

### ***Shërbimi Këshillimor***

Gjatë vitit 2013, Strukturat e Shërbimit Këshillimor në qarqe kanë qenë të pranishme dhe kanë zhvilluar aktivitete ekstensionale si demonstrime, ditë fushe, takime të tjera në grup, seminare, panaire, tavolina të rrumbullakta, etj. Këto aktivitete kanë si synim përmirësimin e shprehive praktike dhe njohuritë e fermerëve .

Nga Strukturat e Shërbimit Këshillimor janë kontaktuar direkt dhe indirekt dhe kanë marrë informacion gjithsej **70 000** fermerë dhe agrobiznese, ose **100 %** e fermerë dhe agrobiznese të synuara.

Gjatë vitit 2013, Strukturat e Shërbimit Këshillimor kanë realizuar aktivitete ekstensionale si trajnime që shërbejnë për kualifikimin e specialistëve dhe fermerëve si dhe të interesuarve të tjerë kryesisht për çështje teknike, ekonomike, organizative, të kooperimit, marketingut, ndryshimet klimatike, trajnime në funksion të skemave mbështetëse etj.

Janë realizuar deri tani **135** ditë trajnime të hapura me specialistë të bujqësisë si dhe **800** ditë trajnime me fermerë të interesuar.

Po kështu, janë shpërndarë për të interesuarit **3 000** libra e broshura si dhe **35 000** fletëpalosje për probleme të ndryshme të teknologjisë në bimë e kafshë, kooperimit bujqësor, menaxhimit të integruar të fermës, etj.

Është tenderuar fondi prej **2.500.000** (dymilion e pesëqindmijë) lekë për “ Shërbime të ofruara në fushën e bujqësisë organike”, metë cilin u realizuan 2 broshura, 4 fletë-palosje, trajnime, demonstrime dhe kërkime në fermë.

Gjithashtu është tenderuar fondi prej **900** mijë lekë për shërbime në fushën e ndryshimeve klimatike dhe për çështjet Gender me të cilin u realizuan për trajnime dhe botimi i 2 fletë-palosjeve.

Qëndrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, kanë përgatitur 4 prej 7 titujve të broshurave divulgative që plotësojnë kërkesat e fermerëve për informacion.

Gjatë vitit 2013, janë realizuar **200** kronika dhe emisione televizive.



## 6. Programi "Menaxhimi I qendrueshem I tokes bujqesore"

Realizimi faktik per vitin 2013 rezulton 16.832 mije leke.pra 89 % ndaj planit fillestar.

Krijimi i Sistemit të Informacionit për Tokën (LIS) dhe Integrimi në Sistemin e Informacionit Gjeografik (GIS) në disa komuna e bashki të Qarkut Elbasan dhe Korçë.

Për vitin 2013 krijimi i sistemit të informacionit për tokën (LIS) dhe intergrimi në GIS është përqëndruar në komunat dhe bashkitë sipas tabelës :

Nr.	Rrethi	Komuna	Sipërfaqja e tokës në Ha.
1	Korçë	Bashkia Maliq	6514
2	Korçë	Pojan	8663
3	Korçë	Vreshtas	9337
4	Elbasan	Bashkia Cërrik	1237
5	Elbasan	Grekan	3454
6	Elbasan	Papër	9021
7	Elbasan	Shirgjan	2043
8	Elbasan	Zavalinë	10431
	Shuma		50.700

Plani për vitin 2013 është 19 milion lekë, i rishikuar 18.3 milion lekë. Realizimin e këtij produkti si 12 muajor 16.8 milion lekë.

Brenda këtij fondi është përfshirë edhe Dixhitalizimi të Regjistrit të Tokës Bujqësore) e cila ka përfunduar në 47 njësi vendore (qarqet Korce, Elbasan, Lezhë).

1. Trajnimi i specialistëve të DAMT-ve në qarqe për dixhitalizimin e regjistrit të tokës bujqësore dhe plotësimi me harta kadastrale.

Plani për vitin 2013 është 1.3 milion lekë, i rishikuar 700 mije leke realizimi si 12 muajor 527 mije leke kryesisht për trajnimin e punonjësve të DAMT-ve lidhur me teknikat e dixhitalizimit të RTB-së si dhe kompletimin e dokumentacionit kadastral. Trajnimi është realizuar në 12 qarqe të vëndit.

## 7. Programi "Administrimi I Ujrave".

Realizimi i shpenzimeve të vitit 2013(vetem 2 muaj, tetor, nentor 2013) për këtë program, që përfaqëson **1 perqind të** realizimit të kësaj ministrie, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korente

45 përqind



- Shpenzimet kapitale 0 përqind
- **Gjithsej 45 përqind**

Për pjesen e mbetur të vitit 2013 me aktin normativ nr.6 date 4.10.2013 ky program u përfshi në buxhetin e MBZHRAU nga Ministria e Mjedisit për muajt nëntor, dhjetor duke mbajtur një akt rekord midis 2 ministrive për pjesën e planit që rialokohen nga njëra ministri tek tjetra dhe referuar këtij plani të mbetur janë parashikuar për këto periudha 3 produkte, në këtë program, të cilat rezultojnë të plotësuar si më poshtë.

Produkti	Buxheti 2013 ne mln leke	Realizimi faktik i 2013		
		Ne milione leke	Ne %	Statusi i realizimit
Monitorime të kryera të kryera nga AUB-te mbi subjekte që shrytezojnë inerte lumore..	8,2	4	49	Pjesrisht
Monitorime të kryera të kryera nga AUB-te mbi përdoruesit e ujit .	2,2	1	45	Pjesrisht
Ndjeka e monitorimit sipas termave të referencës së kontratave.(transfertat me MASH e institute shkencore	0,6	0	0	aspak
<b>TOTALI</b>	<b>11</b>	<b>5</b>	<b>45</b>	

Thëksojmë se nga ana e MBZHRAU ky program është ndjekur vetëm nga ana financiare, nuk është administruar pasi sipas marrëveshjes me ministrinë e mjedisit kështu është rënë dakort, pasi ky program u përfshi në programet e MBZHRAU përkohësisht për pjesën e mbetur të vitit 2013.

Si vjetor 2013 situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve të buxhetit, krahasuar me planin me ndryshime, paraqitet si më poshtë

	<b>% e realizimit kundrejt buxhetit vjetor</b>
1. Programi “Planifikim, menaxhim administrim”	87 %
2. Programi “Siguria ushqimore, mbrojtja e konsumatorit”	109 %
3. Programi “Infrastruktura e kullimit dhe ujitjes”	88,5 %
4. Programi “Zhvillimi rural duke mbështetur prodhimin bujqësor, blegtoral, agroindustrial dhe marketingun”	107 %
5. Programi “Keshillimi dhe informacioni bujqësor”	88 %
6. Programi “Menaxhimi i qendrueshëm i tokës bujqësore”	89 %
7. Programi “Administrimi i Ujrave”	45%
<b><u>Totali Ministrise</u></b>	<b><u>100,8%</u></b>

Duke gjykuar nga realizimi ne vlere i programeve, Sipas zerave perberes te shpenzimeve, situata per vitin 2013 paraqitet e tille:

	<b>Shpenzime Korente</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>
1. Programi “Planifikim, menaxhim administrim”	87%	-
2. Programi “Siguria ushqimore, mbrojtja e konsumatorit”	96%	138 %
3. Programi “Infrastruktura e kullimit dhe ujitjes”	98%	74 %
4. Programi “Zhvillimi rural duke mbeshtetur prodhimin bujqesor, blegtoral, agroindustrial dhe marketingun”	80 %	165%
5. Programi “Keshillimi dhe informacioni bujqesor”	88 %	-
6. Programi “Menaxhimi i qendrueshem i tokes bujqesore”	89 %	-
7. Programi “ Administrimi i Ujrave”	45%	-
<b><u>Totali Ministrise</u></b>	<b><u>90%</u></b>	<b><u>124%</u></b>

Lidhur me shpenzimet korente totale , evidentohet nje realizim i ketyre shpenzimeve ne 90 perqind , krahasuar me planin vjetor . Rezultat i ulet figuron tek Programi “Administrimi i Ujrave me 45 % Programi “Zhvillimi rural duke mbeshtetur prodhimin bujqesor, blegtoral, agroindustrial dhe marketingun” per 45% per shpenzimet korente Theksojme se nga ana e MBZHRAU ky program eshte ndjekur vetem nga ana financiare , nuk eshte administruar pasi sipas marreveshjes me ministrine e mjedisit keshtu eshte rene dakort, pasi ky program u perfshi ne programet e MBZHRAU perkohesisht per pjesen e mbetur te vitit 2013

Realizimi i investimeve, ne total perqindja e realizimit te tyre eshte 124,4% perqind, nga ku investime te drejtpërdrejta eshte realizuar 92 % , kosto lokale 92% , tvsh 49 % dhe financim i huaj 155 %.

Struktura e shpenzimeve per cdo program, sipas buxhetit fillestar 2013, buxhetit me ndryshime 2013 dhe realizimit te vitit 2013, paraqitet si me poshte:

Krahasimi i te dhenave faktike, te raportit te Ministrise me te dhenat e thesarit, per te njejten periudhe raportuese.

<i>Ne milione leke</i>			
Programet	Shpenzime korente	Shpenzime kapitale	Totali i shpenzimeve

	Ministria	Thesari	Dif.	Ministria	Thesari	Dif.	Ministria	Thesari	Dif.
Planif. Menaxh. administrim	223	223	0	0	0	0	223	223	0
Siguria ushqimore, mbrojtja e konsumatorit	1197	1197	0	712	120	592	1909	1317	592
Infrastruktura e kullimit dhe ujitjes	928	928	0	455	317	138	1383	1245	138
Zhvillimi rural duke mbeshtetur prodhimin bujqesor, blegtoral, agroindustrial dhe marketingun	1037	1037	0	992	85	907	2029	1122	907
Keshillimi dhe informacioni bujqesor	189	189	0	0	0	0	189	189	0
Menaxhimi i qendrueshem i tokes bujqesore	17	17	0	0	0	0	17	17	0
Administrimi I Ujrave	5	5	0	0	0	0	5	5	0
<b>Totali i Ministrise</b>	<b>3.596</b>	<b>3.596</b>	<b>0</b>	<b>2.159</b>	<b>522</b>	<b>1.637</b>	<b>5.755</b>	<b>4.118</b>	<b>1.637</b>
Te ardhura jashte limitit	87	87	0	1	1	0	88	88	0

Ashtu sic shikohet edhe nga tabela e mesiperme, te dhenat e paraqitura nga MBZHRAU, per pergatitjen e raportit te monitorimit te shpenzimeve per vitin 2013, nuk perputhen plotesisht me te dhenat e nxjerra nga sistemi i thesarit. Keto diferenca ekzistojne per investimet ne financimin e huaj, pasi ministria e financave nuk i hedh ne softin e saj te gjitha disbursimet per financimet e huaja, konkretisht projektet IPA qe te dhenat ne i marrim nga perfaqesia e Delegacionit European ne Tirane.

*Ne milione leke*

<b>Programet</b>	<b>Buxheti fillestar 2013</b>	<b>Buxheti sipas vkm e f.kontigjence e akt normativi</b>	<b>Buxheti me ndryshime</b>
Planifikim menaxhim administrim	251	4	255
Siguria ushq., mbrojtja e konsumatorit	1987,5	-233.5	1754
Infrastruktura e kullimit dhe ujitjes	1729,4	-167.4	1562
Zhvillimi rural	2572,6	-678.6	1894
Keshillimi dhe informacioni bujqesor	214	1	215
Menaxh. i qendrueshem i tokes bujqesore	21	-2	19
Administrimi i Ujrave	0	11	11
<b>Totali i Ministrise</b>	<b>6.775,5</b>	<b>-1.065,5</b>	<b>5.710</b>

-Ndryshimet ne planin e buxhetit jane per shkak te akordimeve te fondeve per shpenzime operative , ne zbatim te VKM-se nr. 416 date 15.5.2013 “Per nje ndryshim ne VKM 89 date 16.01.2013 “Per përcaktimin e kritereve baze te sektoreve qe do te mbeshteten dhe te mases se përfitimit nga fondi i programit per bujqesine dhe zhvillimin rural per v.2013 .Shuma e akorduar per 200 miljon leke eshte per përballimin e efekteve financiare te kompensimit te tatimit mbi vleren e shtuar qe fermeri ka paguar ne blerjen e inpueteve bujqesore dhe te kafsheve te races.

-Nga fondi i kontigjences per fondin e veçante sipas VKM nr.493, date 6.7.2011 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne VKM nr.929 date 17 .11.2010 “Per krijimin dhe përdorimin e fondit te veçante” jane shtuar 5,2 miljon miratuar me shkresat e ministrise se financave ne menyre periodike. Me aktin normativ jane paksimet e tjera ne shpenzime per 119 miljon leke dhe investime si te brendshme e te huaja per 1.160 miljon leke dhe 8.3 milion leke shtese nga fondi i kontigjences ne shpenzimet e personelit per mbulimin e efektit te rritjes se pagave.

**SEKRETARI I PERGJITHSHEM**

**Auron MËNERI**

Konc.Edlira KOLA  
Entela KOLA  
P/Sek.Beatrice BEZHANI

Drejtor Agron VATA

## **INFORMACION PER REALIZIMIN E INVESTIMEVE TE VITIT 2013.**

Per vitin 2013 jane alokuar fond investime si plan fillestar gjithsejt 2.895 milion leke, i rishikuari 1736 milion leke, nga te cilat investime te brendshme 681 milion leke, financim te huaj 1055 milion leke.

Rezultoni si realizim vjetor investime te brendshme 522 milion leke, e financim te huaj 1.637 milion leke ose ne total 124% nivel realizimi.

### **INVESTIMET E BRENDESHME**

Jane te shperndara vetem ne tre programe buxhetore dhe kryesisht si bashkefinancim i projekteve te huaja.

Vetem tek Programi buxhetor 04240 **jane investime te brendshme 369,4 milion leke realizuar 252 milion leke per te cilat shpjegojme :**

- Rehabilitimi i 44 objekteve te ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga permbytja, nga te cilat 33 objekte i perkasin bordeve te kullimit dhe 11 objekte i perkasin Fondit te Zhvillimit te Rajoneve (qe i perkasin komunave/bashkive).
- Likuidimi i detyrimeve te prapambetura te vitit 2012 per 3 objekte,
- TVSH-ja per Projektin e Burimeve Ujore dhe Ujitjes.

Nga 33 objekte te bordeve te kullimit:

- 18 objekte jane financuar me buxhetin e fillim vitit duke shfrytezuar edhe diferencat e prokurimit.
- 1 objekt "Mbrojtje nga lumi i Semanit i bregut dhe argjinatures te krahut te majte te rrjedhes ne vendin e quajtur Gropa e Rrodhes", Fier me vlere limit 9.9 milion leke, eshte financuar si nderhyrje emergjente gjate muajit shtator 2013 me VKM nr.769, date 13.9.2013
- 14 objekte me vlere limit 29.8 milion leke jane financuar ne fund te vitit 2013 me VKM nr. 1042, date 4.12.2013, si nderhyrje emergjente ne disa diga te rezervuareve dhe argjinatura mbrojtese.

Ne 11 objektet, qe i perkasin Fondit te Zhvillimit te Rajoneve (qe i perkasin komunave/bashkive), punimet jane realizuar sipas financimit te dhene per vitin 2013 dhe 5 prej tyre do te perfundojne gjate vitit 2014.

Investimet e brendshme jane realizuar ne te gjithe objektet, perjashtuar dy objekte te Bordit te Kullimit Lezhe te financuara ne muajin dhjetor 2013 (VKM nr. 1042, date 4.12.2013).

Ne keto dy objekte: "Rehabilitim KUL Kurbin ( Zona Gjorm 2.5 km dhe zona e qytetit Laç ) me vlere 2.5 milion leke" dhe "Rehabilitim i sistemit kullues Hidrovori Tale ( Zhbllokime ne

kolektor ,kanali K-10 –II ,K-11-1 – II , K-11-2-II ), Lezhe me vlere 3 milion leke” per arsye te mungeses se kohes se mjaftueshme punimet nuk u kontraktuan.

Investimet e brendshme gjate vitit 2013 jane adresuar kryesisht per:

- Rehabilitimin e 19 objekteve te ujitjes 142 milion leke
- Rehabilitimin e pjesshem te 10 digave (nderhyrje emergjente) 38 milion leke
- Rehabilitime te pjesshme ne argjinaturat mbrojtese (13 objekte) 130 milion leke

*Me shpenzimet operative* prej rreth 571 milion leke (490 buxheti fillestar) jane financuar:

- Mirembajtja (kryesisht pastrim te kanaleve kullues nga vete bordet e kullimit me mjetet e tyre) ne rreth 75 objekteve te kullimit (kanale kullues) me vlere rreth 110 milion leke. Punimet ne keto objekte kane perfunduar dhe jane kryer kolaudimi dhe likujdimi financiar.
- Mirembajtja (kryesisht pastrim i kanaleve ujites nga vete bordet e kullimit me mjetet e tyre si dhe mirembajtje rezervuar) e rreth 55 objekteve te ujitjes me vlere rreth 89 milion leke. Punimet ne keto objekte kane perfunduar dhe jane kryer kolaudimi dhe likujdimi financiar.
- Mirembajtja e 11 objekteve te mbrojtjes nga permbytja (riparim argjinate) me vlere rreth 15 milion leke. Rezulton se kane perfunduar punimet dhe likujdimi financiar per 11 objekte dhe jane ne proces kolaudimi.
- Pagesa e energjise elektrike per 29 hidrovor per vitin 2013 ishte planifikuar 179 milion leke. Aktualisht rezulton se jane kryer pagesat per energjine elektrike jo vetem per konsumin e vitit 2013, por me shtesen prej rreth 85 milion leke eshte mundesuar edhe pagesa e detyrimeve te prapambetura (principali) ndaj CEZ-it. Ne keto kushte viti 2014 ka filluar pa detyrime (principal) nda CEZ, por theksojme se ndaj CEZ-it egziston detyrimi i kamat vonesave (qe shkojne rreth 120 milion leke)

Theksojme se nderhyrjet e realizuara ne vitin 2013 mundesuan nje sezon ujites pa probleme ne nje siperfaqe rreth 200 000 ha, ndersa kullimi ka pasur nje shtrirje ne rreth 200 000 ha.

Pamvaresisht permbytjeve ne zonen e Zadrimes ne Lezhe nga dalja e lumit Gjader ne mujin Janar, nderhyrjet e realizuara ne hidrovorin e Tales me instalimin e 2 elektropompave te medha (5.5 m<sup>3</sup>/sekond), ben te mundur shmangien e permbytjeve te rreth 4700 ha te zones se Tales, ne Lezhe (referuar situates me rreshje te shumta te janarit 2014)

Per Programet 04220 “Siguria Ushqimore” dhe 04250 “Zhvillimi Rural” financimi i brendeshem i investimeve paraqitet si kosto lokale e tvsh dhe realizimi paraqitet;

Per 04220 niveli i koston lokale eshte 99% ndersa TVSH eshte 44% e nivelit te planifikuar dhe kjo pasi niveli i realizimit te saj varet nga disbursimi i fondeve nga donatori e konkretisht IPA 2010 qe si nivel realizimi paraqitet e ulet pasi zbatimi i kontratave per punime civile ka filluar kryesisht gjate 2013-tes dhe tani vazhdon progresi i punimeve.

Per 04250 niveli i realizimit te kostos lokale eshte 95 % ndersa TVSH paraqitet 66% dhe kjo kryesisht nga mosrealizimi i fillimit te disbursimeve te Projektit IPA 2011'Ipard like'' i cili nga vonesat e fillimit te aplikimeve nuk arriti te financonte pothuajse asnje skeme gjate vitit 2013 si vit i pare i fillimit te tij.

## **Financimi i huaj**

Paraprakisht per financimin e huaj theksojme se niveli i realizimit te tij paraqitet 155% referuar planit dhe kjo pasi disa donatore si IFAD per Mada, meqe projektet jane drejt mbylljes se afateve te tyre intensifikojne disbursimet panvarsisht planit. Gjithashtu disa projekte te IPA kane disbursim fondesh panvarsisht planit dhe te tilla jane si Fondi Garancie per Kreditimin Rural i cili ka disbursuar pothuaj gjithe fondin ne vitin 2013 dhe pritet te filloje zbatimin e tij.

Situata e financimit te huaj per vitin 2013 paraqitet sipas projekteve si vijon:

### **1. Përmirësimi i mbrojtjes së konsumatorëve kundër sëmundjeve zoonotike. PAZA**

Synimi i këtij projekti ka qenë përmirësimi i kontrollit ndaj sëmundjeve zoonotike dhe forcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative për kontrollin dhe mbrojtjen ndaj sëmundjeve zoonotike. Ky projekt ka pasur një buxhet total prej 7.5 milion Euro, nga të cilat 5.7 milion Euro grant i Bashkimit Evropian dhe 1.8 milion Euro bashkëfinancim i Qeverisë Shqiptare. Projekti ka startuar në vitin 2010 dhe përfundoi në 2013.

Një nga arritjet kryesore të Projektit PAZA ka qenë harmonizimi i sistemeve ekzistuese në sektorin e blegtorisë, duke krijuar bazën e të dhënave RUDA. Baza e të dhënave RUDA përmban të dhëna mbi regjistrin kombëtar të fermave dhe të dhëna të detajuara mbi regjistrimin dhe lëvizjet e gjedhëve dhe të imtat. Gjithashtu sistemi RUDA përfshin edhe të dhëna vjetore mbi vaksinimet e realizuara dhe matrikullimin e përvitshëm në blegtori.

Në kuadër të Projektit PAZA janë matrikulluar 2.657.000 të imta në të gjithë vendin. Gjithashtu një nga veprimtaritë më të rëndësishme të realizuara nga projekti ka qenë fushata kombëtare për vaksinimin kundër brucelozës në të imta. Projekti ka siguruar vaksinat për vaksinimin e 2.659.501 të imta në vitin 2012 dhe për 2.039.078 të imta në vitin 2013.

Me bashkëfinancimin e Ministrisë është kryer procesi i vaksinimit të bagëtive të imta kundër brucelozës.

Realizimi i këtyre objektivave është shoqëruar me një trajnim të strukturave publike dhe të veterinarëve privat që kanë qenë pjesë e fushatave për matrikullimin, regjistrimin dhe vaksinimin të realizuara nga Projekti PAZA.

### **2. Konsolidimi i Sistemit të Sigurisë Ushqimore në Shqipëri**

Ky projekt ka një buxhet total prej 3.5 milion Euro në formën e një asistence teknike për forcimin dhe konsolidimin e strukturave administrative përgjegjëse për zbatimin e masave të sigurisë ushqimore në përputhje me BE-në. Projekti ka startuar në Janar 2010. Projekti ka

mbështetur krijimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në përputhje me rekomandimet dhe legjislacionin evropian në fushën e sigurisë ushqimore. Këtij synimi i ka shërbyer furnizimi me pajisje IT të nevojshme për ndërtimin e një sistemi alert online si dhe trajnimi i stafit përkatës. Asistenca teknike ka mbështetur Ministrinë dhe AKU në përafrimin e legjislacionit të BE në fushën e sigurisë ushqimore, përgatitjen e manualëve për procedurat standarde të kontrollit si dhe draftimin e një dokumenti strategjik për laboratorët e sigurisë ushqimore dhe trajnimin e stafit të AKU. Projekti ka përgatitur termat e referencës për punimet për ndërtimin dhe rehabilitimin e zyrave dhe laboratorëve rajonalë të AKU.

### **3. Ndërtimi/Rehabilitimi i zyrave dhe laboratorëve rajonalë të AKU.**

Pas përgatitjes së projekteve ndërtimore me fonde nga projekti IPA 2009, delegacioni Evropian në Tiranë përfundoi tenderin për “Punime për ndërtimin/rehabilitimin e zyrave rajonale dhe laboratorëve të AKU” (ref. EuropeAID/131838/C/ËKS/AL. Nga kompania fituese u nënkontraktuan firmat ndërtuese në rajone, për ndërtimin/rehabilitimin e zyrave e laboratorëve të AKU. Shuma e tenderuar për punimet ishte 4.5 milion Euro me një bashkëfinancim prej rreth 700 mijë Euro që konsistoi në blerje paisje zyrash dhe laboratorësh si dhe TVSH prej 900,000 Euro të cilat u mbuluan me fonde të Ministrisë për vitin 2013.

Problemi kryesor që ka ndikuar në ecurinë normale të këtij projekti ka qënë përgatitja e ambienteve dhe trojeve për rehabilitim/ndërtim si dhe dokumentacioni i nevojshëm për fillimin e punimeve, për këto shkaqe mbarimi i punimeve u shty deri në fund të vitit 2013.

U kryen pagesat për marrjen e lejeve të ndërtimit për laboratorët e qarqeve, si dhe u kryen pagesat e TVSH, sipas situacioneve të punimeve.

### **4. Ndërtimi i Labororit Qendror Veterinar**

Me buxhetin e tij prej 1.2 milion Euro ky projekt synon ndërtimin e një laboratorit Qendror Veterinar pranë Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe të Veterinarisë. Bashkëfinancimi i palës shqiptare është rreth 150 mijë Euro. Edhe ky Projekt ka pasur probleme me lejen e ndërtimit të objektit, problem tashmë i zgjidhur. EUDA ka përfunduar përzgjedhjen e kompanisë për ndërtimin e labororit. Problem tjetër ka qënë pagesa e mbetur pezull ndaj kompanisë 2T sh.p.k/ALB-BUILDING sh.p.k për punimet e kryera nën projektin e Bankës Botërore për Influenzën aviare. Ky problem u zgjidh me Urdhërin e Ministrit me Nr. Prot. 172 dt,17.06.2013 për shlyerjen e këtij detyrimi të prapambetur. Gjithashtu në bazë të situacioneve të punimeve janë kryer dhe pagesat përkatëse për TVSH. Projekti do të përfundojë brenda afateve të përcaktuara.

### **5. Përgatitja e ToR për projektin “Përmirësimi i Mbrojtjes së Konsumatorit kundër sëmundjeve zoonotike” Faza II**

Me një buxhet total prej 4.9 milion Euro prej të cilave 4.5 kontribut i BE-së dhe 0.4 milion Euro bashkëfinancim i Qeverisë Shqiptare, objektivi i këtij projekti është të krijojë dhe zhvillojë një sistem të besueshëm dhe efektiv mbikëqyrje për një kontroll eficient të sëmundjeve të kafshëve. Projekti parashikon të ofrojë asistencë teknike për hartimin e planeve për kontrollin e



sëmundjeve të kafshëve, kryerjen e një fushatë vaksinimi kundër tërbimit, si dhe sigurimin e pajisjeve laboratorike të nevojshme për përmbushjen e objektivit të projektit.

Ka filluar aktiviteti i projektit dhe është disbursuar një pjesë e fondeve. Gjithcka po ecen sipas planit të aktiviteteve të përcaktuara.

#### **6. Krijimi i një Fondi Garancie për Kreditimin Rural.**

Ky Projekt është miratuar nga Komisioni Evropian dhe është firmosur marrëveshja financiare. Projekti. Projekti ka një kosto totale prej 5.5 Milion Euro nga te cilat 5 Milion Euro janë kontributi i Bashkimit Evropian dhe 0.5 Milion Euro është bashkëfinancimi i Qeverisë Shqiptare. Qëllimi kryesor i projektit është nxitja e një përfshirje më të madhe të sektorit financiar shqiptar në zonat rurale me anë të krijimit të një Fondi Garancie për Kredi i cili do të shërbejë për të lehtësuar kredidhënien bankare për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme bujqësore dhe agro-përpunuese. I gjithë fondi pothuajse është disbursuar dhe pritet të fillojë zbatimin i tij.

#### **7. IPA Adriatica**

Për këtë projekt sipas marrëveshjes përkatëse janë kryer një sërë aktivitetesh gjatë vitit 2013, kryesisht shpenzime për: pjesëmarrje në trainime, udhëtime studimore, etj, në fushën e blegtorisë.

#### **8. IBRD “Projekti menaxhimit të ujrave dhe ujitjes “**

rezulton me një realizim 55% dhe ky nivel i ulët shpjegohet se megjithatë janë kryer procedurat e prokurimit për disa objekte (rehabilitim i disa digave të rezervuareve Thane në Lushnje dhe Kurjane në Fier), akoma nuk kanë filluar punimet e zbatimit.

#### **9. Projekti “MADA”** Fondet janë realizuar në një masë më të lartë se fondi i planifikuar për arsye të dibursimeve të fondit nga donatori, për mbylljen e kontratave dhe punimeve. Gjithashtu dhe fondi i planifikuar për TVSH dhe Kosto Lokale është realizuar pothuajse 100%, kjo paralelisht me fondin e harxhuar për financimin e huaj.

Me një realizim jo të kënaqshëm është Grandi Francez.